

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

HARTIM PROJEKTESH " RRUGA E RE SHETITORJA OSUMI- BYPASS" / "RRUGA E RE
BILCE- DROBONIK "

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

(CPV): Projekte:22114311-5

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 10 386 956,34 (dhjete milion e treqind e tetedhjetë
gjashtëmijë e nentëqind e pesëdhjetë e gjashtë presje tridhjetë e kater) leke pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat, ka hartuar proces verbalin për
argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për
procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM
nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i
vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”
si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e
Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë
paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me

përrjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas pikes 1 te shtojces 11 (Kriteret e Pergjithshme per Kualifikim).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure eshte “Sherbim Konsulence”, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ku percaktohet se: “40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimi dhe ne procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020,2021,2022 që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatimit Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”,

të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr.1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2

Shënim: Operatoret ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3 Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe te suksesshëm të kesaj kontrate.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 54 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.1 **Licënsa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

2. PROJEKTUES ARKITEKT

d) Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe te gjelbërta, lulishte e parqe.

4.PROJEKTUES INSTALATOR

i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ,

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

c) Ujësjellës kanalizime urbane- rurale.

d) Projektim Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba,sifona,kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues,priza, baraze, porta, tombino.

6. PROJEKTUES RRUGË-HEKURUDHA

- a) Projektim rrugë lokale, rruge urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- b- Projektim rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

8. PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike

9. STUDIME GJEOLLOGO INXHINERIKE-HIDROGJEOLOGJIK

- d) Studim Vlersim gjeollogo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrushmeri te ulet.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

- a) Projektim sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
2 – d	Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.	Bazuar në termat e referencës, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara, sepse projektuesi do të trajtojë në fazën e projekt zbatimit përveç infrastruktures në rrjetin rrugor edhe të gjitha hapsirat e lira urbane
4-i	Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ	Bazuar në termat e referencës, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara, sepse projektuesi do të hartojë edhe projektin e ndriçimit rrugor
5-b	Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.	Bazuar në termat e referencës, meqënëse kemi të parashikuar infrastrukture të brendëshme rrugore, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
5-c 5-d	Projektim Ujësjellës kanalizime urbane- ruralE Projektim Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba,sifona,kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues,priza,baraze, porta, tombino.	Bazuar në termat e referencës, gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. Bazuar në termat e referencës, krahas realizimit të rrugës parashikohet edhe realizimi i kanaleve , portaleve, tombinove etj), si rrjedhojë gjykohet që këto pika janë të nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
6 - a	Projektimi rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane kryesore	Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve rurale apo urbane, dytësore dhe aksesit të tij me sistemin ekzistues rrugor, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
6-b	Projektim rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore	Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve kryesore dhe rruge interurbane kryesore dhe aksesit të tij me sistemin ekzistues rrugor, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
8 – a	Rilevime inxhinierike	Bazuar në termat e referencës, projektuesi duhet të bëjë azhurnimin e rruges, të jepet plani I piketimit dhe verifikimi paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
9 – d	d- Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe	Bazuar në termat e referencës, studimi gjeologjik dhe hidrologjik do të sigurojë studimet e nevojshme për

	shpateve me qendrushmeri te ulet	realizimin me sukses te sherbimit te kerkuar.
11 – a	Projektim sinjalistike jo ndricuese, në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe dhe parkime.	Bazuar në termat e referencës parashikohet realizimi i rrugeve dhe shesheve te brendeshme eshte e nevojshme parashikimi i realizimit te sinjalsitkes jo ndricuese, tabela dhe vijezim horizontal si pjese integrale e projekteve te infrastruktures rrugore e jo vetem, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe te jenë te perfshirë ne listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar:

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi Strukturist
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeollog

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratrat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për

vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështiresie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor për të cilin kërkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndërtimit do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohet që duhet të paktën **1 (një) inxhinier ndërtimi profili strukturist**, pjesë e stafit teknik.
- Shërbimet për projektimin arkitektonik priten të kenë një volumin të moderuar të projekteve që realizohen në nivelin e objekteve dhe realizimit të peizazhit subjekt i kësaj procedure, si objekte të një kategorie të vecante për të cilin gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) Arkitekti** si staf teknik (arkitekta godinash, peisazhi, etj).
- Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) gjeodet** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve. Si rrjedhojë gjykohet e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri hidroteknik** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të sistemeve elektrike parashikohen bazuar në termat e references, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri elektrik**, si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të studimeve gjeologjike dhe hidrollogjike që parashikohen bazuar në termat e references, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (një) inxhinieri gjeolog/Hidrollogjik**, si pjesë e stafit teknik.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi; profili transport

Për punonjësit e mesipër Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Meqenëse kemi të bëjmë me rikonstruksion të një objekti kompleks siç janë digat dhe rezervuarët përkatës të stafit të mesipër është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;

- **1 (një) inxhinier ndertimi profil transport** , pjesë e stafit ndihmes. Është i domosdoshëm duke qenë se objekti i ndertimit është rrugë me rëndësi të lartë në transportin e qytetit është e rëndësishme të bëhet një projektim i mirë duke përfshirë të gjitha kriteret dhe rregullat e infrastrukturës rrugore, ku merret parasysh aksesueshmëria e mirë, zgjidhja e trafikut, shikueshmëria e linjës rrugore etj
- **1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, gjykohet si i domosdoshëm për realizimin e VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) për projektet që do të realizohen

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 8 (tetë) punonjës për muajin e fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar

b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mesiper perkon me stafin që pritet të jete I angazhuar në keto procedura.*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur dhe të paraqese Çertifikatat të pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** për objektin e prokurimit si më poshtë:

- a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë;
- b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë së mjedisit;

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me natyrën dhe objektin e kontrates që prokurohet.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

***Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*